Lezhë, arrestohet në flagrancë, dyshohet se montonte mina me telekomandë

Një 45 vjeçar është arrestuar në flagrancë pasi akuzohet se montonte mina me telekomandë (me lëndë plasëse C4), për t'ua shitur grupeve kriminale.

HOROSKOPI

Redaksia
26 Janar, 09:43 | **Përditesimi: 26 Janar, 09:55**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Një 45 vjeçar është arrestuar në flagrancë pasi akuzohet se montonte mina me telekomandë (me lëndë plasëse C4), për t'ua shitur grupeve kriminale.

Arrestimi I Ilir Gjonit është kryer në kuadër të opeacionit të koduar "New Start".

> *Në qytetin e Lezhës, shërbimet e Policisë kanë loklaizuar shtetasin e dyshuar I. Gj., i cili mund të transportonte minat me telekomandë dhe kanë ndërhyrë menjëherë për ta ndaluar. Gjatë kontrollit, këtij shtetasi iu gjetën të fshehura në trup, 3 mina me telekomandë, me lëndë plasëse C4, për shpërthim në distancë, dhe një sasi të vogël lënde narkotike cannabis sativa. Nga hetimet e deritanishme dyshohet se ky shtetas i montonte vetë minat, me qëllim shitjen grupeve kriminale, për kryerjen e krimeve kundër personit.*

LEXO EDHE:
FOTO/ Flamingot 'pushtojnë' lagunën Kune-Vain në Shëngjin

Në përfundim të veprimeve procedurale u arrestua në flagrancë shtetasi I. Gj., 45 vjeç, banues në Lezhë, si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 3 minat (të montuara me celularë) dhe sasia e cannabisit.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon puna për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit, si dhe për identifikimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

S.G/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sipas jush kush duhet ta ketë bashkëkryetarin tek 'Zgjedhorja' nga opozita?

PD e Bashës | Bardhi-Berisha | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Lezhë, 3 makina luksoze 'Range Rover' të vjedhura gjatë ditëve të fundit, 2 prej tyre u hapën për 30 sekonda! Autorët humbën gjurmët në Balldren

Elvis Hila

25 Janar, 09:58

Kullimi i tokës bujqësore në Lezhë, në dy vite janë hapur 270 km kanale kulluese! 143 janë planifikuar gjatë 2024

Elvis Hila

24 Janar, 15:38

Lezhë, bashkëfshatarët rrihen për pronën me grushte e lopatë, njëri përfundon në spital me plagë në kokë

Elvis Hila

24 Janar, 12:25

Rrëshen/ I riu kapet mat me 2 mina me telekomandë në çantë! I siguroi në Mal të Zi! Momenti kur e vënë pas murit! (EMRI)

24 Janar, 10:26

Lezhjanët rikthehen tek sobat me dru, Qytetarët: Energjia është e shtrenjtë

23 Janar, 15:33

Lezhë/ Megaoperacioni 'Tempulli', 14 të arrestuar e 10 persona nën hetim gjatë muajve dhjetor e janar

22 Janar, 20:11

Moti/ Përmirësohet situata në qarkun e Lezhës! Hapen rrugët në fshatrat e Mirditës, rikthehet energjia elektrike në pjesën më të madhe të territorit

Elvis Hila

22 Janar, 09:59

Gropë në urën e Milotit, makinat dëmtojnë gomat! Asnjë masë për zgjidhje

21 Janar, 11:50

Moti i keq, problematika në qarkun Lezhë! Shumë fshatra në Mirditë të bllokuara dhe pa energji elektrike

21 Janar, 09:31

Punonjësit e OSHEE, Lezhë sfidojnë kushtet atmosferike, në terren për riparimin e defekteve

20 Janar, 14:48

Tre aksidente nga moti i keq/ Në Korçë furgoni del nga rruga 2 të plagosur! Te Ura e Milotit kamionin e 'merr era'

20 Janar, 11:42

Shi dhe borë në qarkun e Lezhës! Mungesë energjia dhe vështirësi lëvizje ne disa zone në Mirditë! Pezullohet lundrimi për mjetet e peshkimit

20 Janar, 11:38

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje